

## Shoqata Përtej Barrierave

### Thirrje për Ekspert

*për Zhvillimin e Planeve Lokale të Veprimit Rinor në bashki.*

### Termet e Referencës

---

*Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus+ YiA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.*

### Mbi Projektin

Projekti synon të angazhojë këshillat rinorë, aktorët lokalë dhe përfaqësuesit bashkiakë në identifikimin dhe adresimin e nevojave të të rinjve përmes workshop-eve konsultative dhe zhvillimit të Planeve Lokale të Veprimit Rinor. Objektivi është rritja e përfshirjes së të rinjve në qeverisjen vendore dhe nxitja e dialogut të strukturuar ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendimmarrëse. Eksperti do të ofrojë udhëzime, do të lehtësojë seminarët dhe do të ndihmojë në hartimin dhe finalizimin e planeve të veprimit.

### Vendndodhja

Bashkitë Maliq, Sarandë, Tepelenë dhe Gjirokastër

### Periudha a e ofrimit të ekspertizës

3 muaj, Janar-Mars 2025

### Kohëzgjatja e Angazhimit

15 ditë pune

### Objektivat

Eksperti do të punojë ngushtë me stafin e Përtej Barrierave, përfaqësuesit e bashkive, anëtarët e këshillit rinor dhe palët e tjera të interesuara për:

- Lehtësimin e workshop-eve për identifikimin e nevojave të të rinjve;
- Mbështetjen, hartimin, rishikimin dhe finalizimin e Planeve Lokale të Veprimit Rinor;
- Ofrimin e udhëzimeve teknike për politikat rinore, avokimin dhe qeverisjen vendore;
- Konsultë në përgatitjen e prezantimeve dhe materialeve për forumet publike dhe mbledhjet e këshillit bashkiak;
- Konsultë mbi strategjitë për fushatat e avokimit për të promovuar përfshirjen e të rinjve.

### Përgjegjësitë kryesore

- **Lehtësimi i Workshop-eve dhe Konsultimeve:**
  - Zhvillimi i 2 workshopeve një-ditore në 2 bashki për të identifikuar nevojat e rinisë vendase;

- Drejtimi i diskutimeve me pjesëmarrësit për të identifikuar nevojat, prioritetet dhe zgjidhjet e mundshme;
  - Mbledhja dhe analizimi i të dhënave nga konsultimet me të rinjtë dhe palët e tjera të interesit për të mbështetur hartimin e Planeve Lokale të Veprimit.
- **Zhvillimi i Planit të Veprimit:**
- Mbështetja e vazhdueshme e këshillave rinorë dhe stafit të bashkive për të hartuar Plane Lokale të Veprimit që adresojnë nevojat dhe prioritetet e të rinjve në komunitet;
  - Sigurimi i ekspertizës mbi praktikatat më të mira në politikatat rinore dhe qeverisjen vendore;
  - Rishikimi dhe këshillimi mbi projekt-planet e veprimit, duke siguruar përputhshmëri me politikatat lokale dhe prioritetet rinore.
- **Avokimi dhe Forumet Publike:**
- Konsultimi i anëtarëve të këshillit rinor në përgatitjen për forume publike ku do të prezantohen planet e veprimit;
  - Ofrimi i mbështetjes për të rinjtë në advokim dhe të folurit në publik;
  - Zhvillimin e materialeve komunikuese për fushatën ndërgjegjësuere.
- **Angazhimi i aktorëve të përfshirë në projekt:**
- Lehtësimi i dialogut të strukturuar ndërmjet të rinjve dhe pushtetit lokal;
  - Pjesëmarrja në takime zyrtare me këshillat bashkiakë për të paraqitur dhe diskutuar planet e veprimit.
- **Raportimi dhe dokumentacioni:**
- Përditësim i rregullt pranë stafit të Përtej Barrierave dhe një raport përfundimtar mbi workshopet, zhvillimin e planit të veprimit dhe përpjekjet e avokimit duke përfshirë rezultatet kryesore dhe rekomandimet.

### **Kriteret për aplikim**

- Diplomë e avancuar në shkencat sociale, politikat publike, zhvillimin e të rinjve ose fusha të ngjashme;
- Kualifikime dhe certifikata shtesë në trajnime për politikat publike, avokimin dhe planifikimin strategjik janë të preferueshme;
- Të paktën 3 vjet përvojë pune me programe rinore, qeverisje vendore ose zhvillim të komunitetit;
- Eksperiencë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të trajnimit dhe workshop-eve, veçanërisht në kontekstin e rinisë dhe zhvillimit të komunitetit;
- Njohuri mbi mekanizmat dhe strategjitë e avokimit dhe mundësitë për angazhimin e të rinjve në procese vendimmarrëse;
- Njohuri të thella mbi politikatat rinore dhe planifikimin strategjik në nivel lokal dhe kombëtar;
- Përvojë në hartimin e dokumenteve të politikave ose planeve të veprimit;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe dialogut publik;
- Aftësi në analizimin dhe interpretimin e të dhënave, si dhe në hartimin e raporteve dhe dokumenteve përfundimtare;
- Njohuri të gjuhës angleze.



### **Dokumentet e nevojshme për aplikim**

- Jetëshkrim (CV)
- Letër interesi
- Ofertë financiare [Link](#)

### **Procedura e Vlerësimit**

Zgjedhja e ekspertëve do të bazohet në: se sa mirë aplikimi përmbush kërkesat e përcaktuara në termat e referencës.

*Kandidatët e interesuar duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës **30 Shtator 2024**, në adresën elektronike: [office@beyondbarriers.org](mailto:office@beyondbarriers.org)*

*\*Ju lutem konsideroni që vetëm kandidatët fitues do të kontaktohen.*